

Wn. 1195/2022
14/07/2022

17



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

URDHËR

Nr. 90, datë 14.07/2022

MBI

“MARRJEN E MASAVE ORGANIZATIVE PËR ZBATIMIN E URDHËRIT TË PËRBASHKËT NR. 8, DATË 30.06.2022 “PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2022 - 2023”, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; **Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 436, datë 03.06.2020, Për “përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2020-2021” dhe 2021-2022 e në vijim; Urdhri i përbashkët Nr. 8, datë 30.06.2022, “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2022-2023”; Udhëzimit Nr. 10, datë 15.05.2019, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë”, Udhëzimi Nr.16, datë 29.06.2022 Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin Nr.10, datë 15.05.2019, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar; si dhe Vendimeve të Senatit Akademik të Universitetit të Arteve si më poshtë: VSA Nr. 09, datë 02.02.2022; VSA Nr. 10, datë 02.02.2022; VSA Nr. 11, datë 02.02.2022, VSA Nr. 17, datë 10.03.2022; VSA Nr. 18, datë 10.03.2022; VSA Nr. 19, datë 10.03.2022,**

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit të monitorimit të zhvillimit të konkurseve të pranimit, në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2022 - 2023, me përbërje si më poshtë:

- Prof. Arian Paço
 - Prof. Dr. Erald Bakalli
 - Znj. Suela Kromidha
2. Konkursët e pranimit për të gjitha programet e studimit të ofruara nga Fakultetet e UART do të zhvillohen nga data **22 Gusht 2022 deri më datën 25 Gusht 2022**.
 3. Administruesi i UART, për sistemin e Portalit U-Albania (Përgjegjësi i sektorit të IT) të marrë masat që brenda **datës 06 Gusht 2022**, të shkarkojë nga Portali U-Albania listën e aplikantëve që konkurrojnë në programet e studimit të ofruara nga UART dhe tua përcjellë Sekretarive mësimore për secilin Fakultet si dhe ti publikojë në faqen zyrtare elektronike të UART, sipas përcaktimeve ligjore.
 4. Sekretaritë mësimore të Fakulteteve të UART, brenda **datës 06 Gusht 2022**, ti afishojnë në mjedisët e fakulteteve listën e aplikantëve për konkursët e pranimit 2022-2023.
 5. Regjistrimi i konkurrentëve për në konkursët e pranimit në programet e studimit me kohë të plotë Bachelor, në të gjitha Fakultet e UART, për të gjitha programet e studimeve të ofruara bëhet pranë sekretarive mësimore, dhe fillon në datën **15 Gusht 2022 nga ora 08:00 deri në orën 16:00**. Konkurrentët të regjistrohen deri në ditën dhe orarin e përcaktuar nga secili Fakultet për fillimin e konkurseve të pranimit.
 6. Dokumentacioni për tu regjistruar në konkursët e pranimit është:
 - Mandati i pagesës së tarifës të konkurrimit.
 - Fotokopje të kartës së identitetit ose të pasaportës.
 7. Regjistrimi pranë sekretarive përkatëse bëhet nga vetë konkurrenti ose nga një person i autorizuar prej tij/saj, me prokurë të posaçme.
 8. Kanë të drejtë të regjistrohen për në konkursët e pranimit të ciklit të parë Bachelor, vetëm kandidatët sipas listës së shkarkuar nga portali U-Albania.
 9. I gjithë kalendari i procedurave do të bëhet në zbatim të **Urdhri i përbashkët Nr. 8, datë 30.06.2022**, "*Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2022-2023*".
 10. Të afishohen në mjedisët e secilit nga Fakultetet e UART, Urdhrat/Vendimet mbi masat e marra për konkursët e pranimit, rregulloret dhe kriteret e konkurseve të pranimit, si dhe çdo procedurë tjetër të nevojshme për këtë proces.
 11. Strukturat përgjegjëse të secilit fakultet të marrin masat e nevojshme për zhvillimin e konkurseve të pranimit si dhe ndjekjen me përgjegjësi të afateve të përcaktuara sipas etapave të zhvillimit të konkurseve dhe procedurave të regjistrimit të kandidatëve/studentëve deri në

përcjelljen e tyre për numër matricullimi në zbatim të kalendarit të Urdhrit të përbashkët Nr. 8, datë 30.06.2022.

12. Marrjen e masave të nevojshme të protokollit për parandalimin e përhapjes së Covid 19, të të gjitha strukturave drejtuese akademike dhe administrative të UART.
13. Sektori i shërbimeve si dhe Fakultet në UART të marrin masat e nevojshme për përgatitjen e ambienteve në të cilat do të zhvillohen konkurset e pranimit për të gjitha programet e studimit.
14. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri anëtarët e grupit të monitorimit, Dekanët e Fakulteteve të UART, Përgjegjësit e Njësive Bazë, Sekretarët e Fakulteteve, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Bibliotekës, Sektori Mësimor, Sektori i Teknologjisë Informacionit, Sektori i Statistikë Informacionit, Sektori i Shërbimeve dhe çdo strukturë tjetër në ndihmë të këtij procesi.
15. Të njoftohet për marrjen e masave të veçanta për administrimin dhe ruajtjen ambienteve të UART, për periudhën e konkurseve, shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike ILLYRIAN GUARD.
16. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare të Web-it, të Universitetit të Arteve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

REKTORI

Prof. Kastriot ÇAUSHI

